



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 400/2 Prot.

Tiranë, më 03.07.2023

**V E N D I M**

Nr.59, datë 03.07.2023

**Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të aktit nr. 36, datë 06.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë Finiq, për lirimin e nëpunësit \*\*\*\*\* , nga detyra “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve dhe emërimin e tij në pozicionin “Inspektor”, pranë Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike në Njësinë Administrative Livadhja, Bashkia Finiq.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa pretendime prej nëpunësit \*\*\*\*\* , për paligjshmëri në procesin e nxjerrjes së aktit nr. 36, datë 06.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë Finiq.

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një informacioni të regjistruar me nr. 400 prot., datë 13.04.2023, paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\* , janë ngritur pretendime për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, të kryera gjatë procesit të nxjerrjes së aktit nr. 36, datë 06.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë Finiq, për lirimin e nëpunësit \*\*\*\*\* , nga detyra “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, dhe kalimin e tij në pozicionin *Inspektor*”, pranë Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike në Njësinë Administrative Livadhja, Bashkia Finiq.

Në parashtrimet e tij, ky nëpunës pretendon se, është emëruar nëpunësit civile, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, në detyrën “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, (kategoria e pagës III-a/1), në Bashkinë Finiq.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, u shqyrtua materiali shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunësit dhe dokumentacioni i përcjellë nëpërmjet postës elektronike (e-mail) nga njësia e burime njerëzore të Bashkisë Finiq, datë 05.05.2023, “Përgjigje”, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Nga shqyrtimit i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se ky nëpunës, është emëruar rregullisht, në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, në detyrën “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, (kategoria e pagës III-a/1), në Bashkinë Finiq, me aktin nr. 1785, datë 08.07.2022, të njësisë së burimeve njerëzore dhe aktualisht gëzon statusin e nëpunësit civil.

Ky nëpunës ka vijuar punësimin e tij në këtë detyrë, deri në momentin kur me urdhrin nr.36, datë 06.04.2023, Kryetari i Bashkisë Finiq, ka vendosur lirimin nga detyra e mësipërme dhe kalimin e tij në pozicionin “Inspektor”, pranë Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike në Njësinë Administrative Livadhja, Bashkia Finiq.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë të urdhërit nr. 36, datë 06.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë Finiq, për kalimin e nëpunësit \*\*\*\*\* nga pozicioni “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, (kategoria e pagës III-a/1), në pozicionin, me kategori më të ulët, “Inspektor”, pranë Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike në Njësinë Administrative Livadhja, konstatohet se jemi para një akti të paligjshëm.

Paligjshmëria e tij konsiston së pari, në faktin se nuk identifikohet shkaku i nxjerrjes së tij dhe nuk përcaktohet natyra e cenimit të marrëdhënies së punësimit të nëpunësit në fjalë. Konkretisht, nuk mund të përcaktohet nëse jemi përpara një transferimi të përkohshëm, një transferimi të përhershëm, para dhënies së një mase disiplinore, apo përpara ndonjë mosmarrëveshje me natyrë tjetër.

Së dyti, në pikën “g”, të nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, përcaktohet se Kryetari i Bashkisë, ka të drejtë të emërojë dhe shkarkojë punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil.

Pra, kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e nëpunësve të strukturave në vartësi të tij, është e kufizuar në raport me nëpunësit civilë, pasi për emërimin, shkarkimin, transferimin apo ndëshkimin disiplinor të tyre, parashikohen organe dhe procedura të tjera, të veçanta, përcaktuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe në aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatimin e tij.

Konkretisht, nëse jemi para një transferimi të përkohshëm, veprimet duhet të kryheshin sipas kërkesave të nenit 48, të ligjit nr 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ose nëse jemi para një transferimi të përhershëm, duhet të respektoheshin kushtet e nenit 49, të ligjit në fjalë, e kështu me radhë për të gjitha institutet e ligjit. Ndërkohë, këto dispozita, përcaktojnë shprehimisht, edhe organet apo organizmat konkrete, të cilat kanë kompetencën të vendosin, sipas procedurave të përcaktuara në dispozitat në fjalë dhe në vendimin nr. 125 dt. 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të cilat nuk janë respektuar nga subjekti që ka nxjerrë aktin (*Kryetari i Bashkisë Finiq*).

Pra, nxjerrja e urdhrit nr. 36, datë 06.04.2023, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Finiq, në kushtet kur nëpunësi \*\*\*\*\*, është nëpunës civil, është një veprim administrativ i paligjshëm, i kryer në mungesë të kompetencës, parregullsi kjo e parashikuar nga germa “a” e nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”; ndërkaq, ky veprim administrativ është kryer gjithashtu, në kushtet e shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative, shkelje kjo e bazuar në germën “b” të dispozitës në fjalë, si rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë të paligjshme, parashikuar nga pika “dh”, e kësaj dispozite.

Nga sa u parashtrua më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar konstatohet se, mosrespektimi i procedurës së mësipërme ligjore, në kuptim të nenit 109, germa “a”, “b”, dhe “dh”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcakton paligjshmërinë e aktit nr. 36, datë 06.04.2023, të Kryetarit të Bashkisë Finiq.

#### **Për këto arsye:**

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të nenit 109, gërmat *a*, *b* dhe *dh*, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

## VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Finiq, që të urdhërojë anulimin e aktit nr. 36, datë 06.04.2023, për lirim të nëpunësit \*\*\*\*\* , nga pozicioni “Përgjegjës Sektor”, në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, dhe kalimin e tij në pozicionin, “Inspektor”, pranë Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike në Njësinë Administrative Livadhja, duke e kthyer nëpunësin në fjalë në pozicionin e mëparshëm, ku ai ka emërimin e rregullt. Njëkohësisht, në aktin e mësipërm, organi publik duhet të shprehet edhe për rregullimin e pasojave, ku të përfshihet edhe pagesa e diferencës së pagës.
2. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, ngarkohet njësia përgjegjëse e Bashkisë Finiq, duke lënë 20 ditë afat, nga data e komunikimit të vendimit.
3. Për këtë vendim të njoftohen, Kryetarit të Bashkisë Finiq, njësia përgjegjëse e Bashkisë Finiq dhe nëpunësi \*\*\*\*\* .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**